




REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KËSHILLI I BASENIT UJOR SHKUMBIN**



**VENDIM**

**Nr.6, datë 04.07.2022**

**PËR**

**KORIGJIMIN E GABIMIT NË LEJEN ME NR. 488 PROT., DATË 9.8.2021**  
**DHËNË ME VENDIM NR. 2, DATË 29.7.2021 PËR MIRATIMIN E**  
**LEJES “PËR PËRDORIM TË BURIMIT UJOR SIPËRFAQËSOR**  
**PËR PRODHIM HIDROENERGJITIK”, SHOQËRISË “JOVA**  
**COMPANY” SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, si dhe pikën 1 e 2, neni 112, të Kodit të Procedurave Administrative “Korrigjimi i gabimeve materialeve në aktin administrativ” me kërkesë të subjektit dhe me aprovimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore pasi konstatoj se kërkesa e subjektit qëndron dhe pasaktësia është si pasojë e një gabimi material, Këshilli i Basenit Ujor Shkumbin

**V E N D O S I:**

1. Korrigjimin e gabimit material në lejen me nr. 488 prot., datë 9.8.2021 dhënë me vendim nr. 2, datë 29.7.2021 për miratimin e lejes “Për përdorim të burimit ujor sipërfaqësor për prodhim hidroenergjitik”, shoqërisë “Jova Company” sh.p.k.
2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

***Përmbatja e Projektit të miratuar me lejen nr.488 prot., datë 9.8.2021***  
**HEC NIÇA**

Vepra e marrjes nr.1

- X=539834, - Y=4521329, - Z=1.780 m.m.n.d

Vepra e marrjes nr.2

- X=540002, - Y=4521039, - Z=1.784 m.m.n.d

Vepra e marrjes nr.3

- X=539834, - Y=4521329, - Z=1.784 m.m.n.d

**Godina e Centralit**

- X=543467, - Y=4521553, - Z=1.372 m.m.n.d

- Qmes=0.0099 m<sup>3</sup>/s

- Qllog=0.385 m<sup>3</sup>/s

- Qeko=0.0099 m<sup>3</sup>/s

- Fuqia e instaluar N=1.300 Kw

- Energjia Vjetore E=2.651.080 Kw/vit

-

***Përmbatja e Projektit të Propozuar me koordinatat e korigjuara***

**HEC NIÇA**

Vepra e marrjes nr.1

- X=539546, - Y=4521122, - Z=1.780 m.m.n.d

Vepra e marrjes nr.2

- X=540002, - Y=4521039, - Z=1.784 m.m.n.d

Vepra e marrjes nr.3

- X=539834, - Y=4521329, - Z=1.784 m.m.n.d

**Godina e Centralit**

- X=543467, - Y=4521553, - Z=1.372 m.m.n.d

- Qmes=0.0099 m<sup>3</sup>/s

- Qllog=0.385 m<sup>3</sup>/s

- Qeko=0.0099 m<sup>3</sup>/s

- Fuqia e instaluar N=1.300 Kw

- Energjia Vjetore E=2.651.080 Kw/vit

3. Zbatimi i kontratës koncesionare nuk duhet të pengojë kërkesat e komunitetit dhe të organeve të qeverisjes vendore për përdorimin e ujit

për ujitje dhe për prodhimin e ujit të pijshëm, si dhe nuk duhet të shkaktojë rreziqe, fatkeqësi natyrore dhe fatkeqësi të tjera.

4. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas zbardhjes formalisht dhe njoftimit të subjektit të interesuar.

**KRYETARI I KBU SHKUMBIN**

